

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2022*

20.05.2022

Ora 15:07

**RENDI I DITËS**

**Hedhja e shortit për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 9, me ankues zonja Emiriana Sako, Kryetare e Bashkisë Durrës, me objekt “Kundërshtimi i vendimit nr. 152, datë 28.04.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.**


**PJESËMARRJA :**

- **KAS:**
- **Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema**

**Z. Y. Merkaj:** Përshëndetje të gjithëve! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 19.05.2022 është paraqitur Kërkesa Ankimore nr. 9 me ankues Kryetaren e Bashkisë Durrës zonja Emiriana Sako. Objekti i ankimit është kundërshtimi i vendimit nr. 152, datë 28.04.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Armath” dhe kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës zonjës Emiriana Sako”. Referuar nenit 14 të rregullores së KAS-it, kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në njëren prej tyre është vendosur Kërkesa Ankimore nr. 9, të cilat palosen dhe futen në 5 gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë të cilat vendosen në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezentë në sallë, atëherë një përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre duke filluar nga rendi alfabetik rritës me zotin Elvin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe Ledio Braho. Pasi janë mbyllur të pesë goglat përziejhen nga përfaqësuesi i KQZ-së dhe:

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako – Kërkesa Ankimore nr. 9.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.20.05.2022*

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit, relatori i Kërkesës Ankimore nr. 9 është zoti Elvin Lako, ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

